



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni vjeshtor
Komisioni për Integritet Evropian
Mbledhja nr. 32.
Prishtinë, më 27.11. 2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Armend Zemaj, Fikrim Damka, Ismajl Kurteshi, Fatmire Kollçaku, Visar Ymeri, Ismet Beqiri, Zenun Pajaziti dhe Milaim Zeka.

Munguan: Blerta Deliu-Kodra, Donika-Kadaj-Bujupi dhe Adem Hoxha.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli dhe Safet Beqiri.

Pjesëmarrësit tjerë: përfaqësuesi nga KDI dhe mediat.

Mbledhjen e kryesoi Armend Zemaj, nënkryetar i parë i komisionit.

Kryesuesi, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, e hapi mbledhjen e komisionit, me këtë

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datës 13.11.2018 dhe 14.11.2018;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, me**

- amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 Ligji i sportit, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 për sport, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
 7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
 8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Kryesuesi, Armend Zemaj, konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datës 13.11.2018 dhe 14.11.2018

Kryesuesi konstatoi se procesverbalet e mbledhjeve të datës 13.11.2018 dhe 14.11.2018, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Kryesuesi, tha se çështjet e rregulluara dhe adresuara me këtë projektligj, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së.

Andaj, konstatoj se ky projektligji me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në Kuvend. Më pas, hapi diskutimin.

Pasi nuk kishte diskutues të paraqitur, kryesuesi e hodhi në votim projektligjin, pas votimit, konstatoi se komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr.06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale, me amendamentet e Komisionit Funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Kryesuesi tha se çështjet e rregulluara dhe të adresuara me këtë projektligj, si dhe projektligjet e tjera që i kemi sot për shqyrtim e që ndërlidhen me fushën e sportit, kanë për qëllim harmonizimin me legjislacionin tonë të brendshëm, përkatësisht me Ligjin për kundërvajtje.

Andaj, konstatoi se ky projektligji me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në Kuvend. Lidhur me këtë, hapi diskutimin.

Pasi nuk kishte diskutues të paraqitur, kryesuesi e hodhi në votim projektligjin, pas votimit, konstatoi se komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Kryesuesi, tha se çështjet e rregulluara dhe të adresuara me këtë projektligj, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së.

Andaj, konstatoi se ky projektligj me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në Kuvend. Hapi diskutimin.

Pasi nuk kishte diskutues të paraqitur, e hodhi në votim projektligjin, dhe pas votimit, konstatoi se komisioni, me shumicë votash, nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24, Ligji i sportit, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 për sport, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Kryesuesi theksoi se çështjet e rregulluara dhe të adresuara me këtë projektligj, janë lënë në kompetencë të brendshme të shteteve anëtare të BE-së.

Pasi nuk kishte diskutues të paraqitur, ftoi anëtarët të deklarohen me votë për këtë projektligj.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24, Ligji i sportit, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 për sport, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Kryesuesi theksoi se jeni të njoftuar për debatin parlamentar dhe punën e bërë nga Komisioni funksional për Arsim dhe Teknologji, lidhur me këtë projektligj. Çështjet e rregulluara dhe të adresuara me këtë projektligj, janë lënë në kompetencë të brendshme të shteteve anëtare të BE-së.

Andaj, konstatoi se ky projektligj, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Më tej, për këtë projektligj, hapi diskutimin.

Ismajl Kurteshi, si anëtar edhe i Komisionit për Arsim, tha se ky projektligj, në të gjitha fazat që është diskutuar për të dhe në dy debate publike që janë organizuar, kanë qenë të njoftuara edhe institucionet ndërkombëtare, siç janë : Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Komisioni Evropian, të cilët kanë dhënë vërejtjet dhe sugjerimet e tyre, prej të cilave, një pjesë e tyre janë marrë parasysh. Pra, për faktorin ndërkombëtar ky ligj nuk është i panjohur.

Milaim Zeka, tha se e kam një shqetësim, sepse kemi disa ligje dhe disa kërkesa që seriozisht e rrezikojnë buxhetin e shtetit dhe nëse vazhdojmë me këtë ritëm, kam frikë se shumë shpejt do ta bankrotojmë buxhetin e shtetit. Kam vërejtur një etje të jashtëzakonshme të shoqatave dhe sindikatave të ndryshme për rritjen e rrogave, pa u bazuar në mundësit tona reale. Për ligjin për nivelimin e pagave, kam dhënë një propozim që t'iu hiqen privilegjet 2000 personave që më së shumti i kushtojnë buxhetit të Kosovës me privilegjet e tyre. Pra, është e papranueshme që njerëzit që kanë bartë funksione të larta për të pasur privilegje deri në vdekje dhe po ma merr mendja se kështu po e çojmë shtetin në bankrotim dhe e kam hallin për fëmijët tanë dhe mbi bazën e kësaj, mendoj se edhe ky ligj, më tepër është bërë për çështje të votave. I kuptoj brengat e të gjithë arsimtarëve dhe heroizmin e këtyre njerëzve që e kanë bërë në vitet e

90-ta. Po e përsëris atë që e kam thënë në foltoren e Kuvendit se këta njerëz janë paguar në atë kohë prej tre përqindëshit dhe ky është një fakt i pa diskutueshëm, mua më dhimbën njerëzit, të cilët kanë lëshuar shtëpi me qira dhe nuk kanë marrë kurë qira. Unë kështu mendoj dhe ndoshta e kam gabim, por në foltoren e Kuvendit dhe në komision nuk flas vetëm për të marrë vota, por flas qysh ma merr mendja për të ardhmen e Kosovës, sepse në mandatin e ardhshëm, ndoshta nuk do të jem deputet, por Kosova do të jetë këtu dhe fëmijët tanë do të jenë këtu.

Visar Ymeri, tha se mbase e di që komisioni ynë nuk është as vendi i duhur dhe as entiteti i duhur për të cilin do të diskutojmë çështjet rreth këtij ligji, sepse ne këtu e kemi një fushëveprim më të ngushtë, pra të vlerësimit dhe diskutimit të përputhshmërisë se ligjeve me BE-në. Megjithatë, mendoj se ky ligj del goxha jashtë këtij fushëveprimi, sepse ky rregullon një çështje konkrete të një periudhe goxha të veçantë për Republikën e Kosovës dhe nuk ka diçka në BE që e rregullon këtë çështje, sepse nuk e kanë pasur këtë problem. Këtu po flasim për angazhimin e një pjese të shoqërisë sonë gjatë viteve të 90-ta, për të mirëmbajtur një jetë shoqërore të organizuar gjatë viteve të 90-ta, që ka qenë e organizuar jashtë realitetit institucional të atëhershëm, të okupuar nga Serbia.

Mendoj se këtë duhet ta shtrojmë nga dy drejtime: njëra është që ka të bëjë me racionalitetin financiar të një ligji të tillë, i cili paraqet ose nuk paraqet, varësisht si e vlerësojnë, një barrë shtesë për buxhetin e Kosovës, dhe kur bëhen bashkë të drejtat, të cilat u jepen kategorive të ndryshme të shoqërisë, atëherë duhet në fund dikush të përdor një gjuhë pak më të thjeshtë dhe të llogaritet sa do të na kushtojë kjo, në vazhdimësi.

Këtu nuk po flasim për një shumë që do të paguhet vitin e ardhshëm, por këtu po flasim për një zotim që e merr shteti, në vazhdimësi, për kategorinë që po flasim dhe këtë të drejtë do ta gëzojë deri në fund të jetës. Me këtë ligj, ky lloj pensioni është i trashëgueshëm edhe pas individit që e gëzon të drejtën e pensionit. Ky diskutim do të duhej të ndodhte në Komisionin për Buxhet dhe Financa, sepse ata do të kenë më shumë informata të përgjithshme dhe ta dinë për barrën buxhetore.

Mendoj se është gabim, në përgjithësi, jo vetëm për kategorinë për të cilën po flasim, që kemi skema të ndryshme pensionale dhe kështu ta parcializojmë të drejtën e pensionit ,andaj çështjen e pensioneve duhet ta rregullojmë me një kod pensional, në të cilin përmblihen të gjitha kontributet e ndryshme që i ka dhënë, cilido prej qytetarëve në etapat e ndryshme të jetës së tij profesionale e aktivizimit publik. Pastaj, këto kontribute të ndryshme të grumbulluara, ta japin edhe një benefit pensional, i cili do të ishte i konsoliduar. Mendoj se vetëm kështu do të krijojmë një skemë që duket komplekse, por që do të garantonte një barazi pak më të madhe qytetare, dhe në anën tjetër, një mundësi e projektimit për të ardhmen e qëndrueshmërisë financiare, për të ardhmen e Republikës së Kosovës.

Kurse, e dyta, është që mund të bie në fushëveprimin e këtij komisioni, është se ne duhet të mendojmë edhe pak për barazinë e qytetarëve. Punëtorët e arsimit gjatë viteve 90-ta, kanë qenë të angazhuar për mirëmbajtjen e sistemit paralel të ndërtuar nga Republika e Kosovës, atëherë. Në këtë drejtim, e konsideroj si të nevojshme dhe të

drejtë që t'u njihet ky stazh pune dhe kontributi i tyre, por nuk mund të themi se gjatë viteve 90-ta, kategoritë tjera nuk kanë kontribuar për shoqërinë, sepse disa kanë kontribuar, duke punuar e disa duke mos punuar, sepse kanë qenë të përjashtuar nga puna, atëherë duhet pasur kujdes ndaj të gjithëve, duke u dhënë kompensimin. Nuk mund të përjashtohet dhe të kategorizohet në këtë mënyrë kontributi i qytetarëve, duke thënë se këta janë kontribuues e të tjerët nuk kanë kontribuar.

Sa i përket fushëveprimit të komisionit, këtë ligj nuk mund ta kthejmë prapa, megjithatë duhet të bëhemi me të arsyeshëm dhe ë; te kujdesshëm ne këto çështje te cilat i takojnë problemeve edhe shoqërisë sonë.

Më e rëndësishme për punëtorët e arsimit është që ta rrisim koeficientin e pagës për ta, në ligjin për paga, kurse t'ua ulim koeficientin shumë të lartë përfaqësuesve politikë, sesa të kompensohen. Megjithatë, stazhi i punës së asaj kohe duhet të njihet plotësisht dhe të llogariten në kalkulimin përfundimtar të pensionit.

Ismet Beqiri, pajtohet parimisht se po rendohet buxheti i Kosovës, por tha se nuk jam sot, që prej këtij momenti të ndërpritet, në kuptimin e asaj që mos të njihet kjo e drejtë, sepse mendoj se të gjithë kanë kontribuar gjatë viteve të 90-ta, por punëtorët e arsimit dhe të shëndetësisë janë veçuar.

Po ashtu, pajtohem që në një të ardhme, të shihet sesi të rregullohet për të gjitha kategoritë tjera, por nuk jam që sot mos të procedohet dhe e mbështes këtë projektligj, sepse bëhet fjalë për kategori mjaft të madhe të njerëzve tanë, që kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm gjatë këtyre viteve dhe është e vërtetë që po mos të ishin ata njerëz dhe ai organizim, do të kishim gjenerata të tëra analfabetësh dhe si shenjë mirënjohje dhe respekti, sigurisht, me një ligj të tillë duhet t'u njihet ky kontribut, ndërkaq në një të ardhme, gjithmonë ligjet mund të plotësohen, mirëpo është dashur që kjo punë të nisët edhe më herët, sepse e kemi sakatuar buxhetin për disa që nuk ka pasur nevojë hiç. Pra, janë futur emra dhe njerëz që nuk e meritojnë fare për kategoritë e caktuara, por nuk dua ta çel këtë temë, sepse janë organet tjera që duhet të merren me këtë, por fuqishëm e përkrahu një ligj të tillë dhe në një të ardhme, duhet të gjitha grupet parlamentare të gjejnë një zgjidhje, për të pasur diçka që do t'i përfshinte të gjitha kategoritë, dhe në anën tjetër, do ta ruante buxhetin, sepse kur bëhet e njëjtë për të gjithë, në një mënyrë, aq sa ka mundësi, kjo edhe ruan pak buxhetin.

Zenun Pajaziti, tha se ky është një prej ligjeve që është rezultat i debatit politik brenda nesh, si propozim para fushatash dhe kemi ardhur aty ku jemi. Po ashtu, jam kureshtar ta di se qysh do të japë sugjerimin e vet Komisioni për Buxhet dhe Financa. Komuniteti i arsimit, pa dyshim është komuniteti më meritor, por kur kemi ardhur të bisedojmë sa kushton financiarisht dhe kur na është dhënë prej ekspertëve, pasi është bërë propozimi, kemi filluar të themi se ka edhe të tjerë që kanë kontribuar për këtë vend dhe mos po u hyjmë në hak edhe të tjerëve, kemi filluar të bëhemi më racional.

Është bërë një premtim nga të gjitha grupet politike dhe kemi folur për t'i kompensuar. Kemi ligje që u përmendën se duhet të rregullohen edhe më mirë dhe t'u njihet përvoja e punës për ata që janë gjallë.

Propozoj që ta votojmë këtu dhe në seancë, pasi e kemi sjellë deri këtu, atëherë le ta përfundojmë.

Fatmire Kollçaku, tha se përveç nevojës për njohjen e kontributit edhe të punëtorëve të shëndetësisë dhe mungesa e reformës së sistemit pensional, krijon probleme dhe rritjen e presionit, sidomos nga punëtorët e arsimit, sepse shumica prej tyre nuk po arrijnë të realizojnë 15 vjet stazh pune para luftës, ndërsa pas luftës e kemi ndërruar komplet sistemin pensional dhe faktikisht asnjëri nga ne nuk kemi stazh pune, do të thotë në periudhën e pasluftës, fare nuk njihet stazhi i punës dhe krejt ky presion i madh, kryesisht është për shkak se përveç që kanë kontribuar në atë periudhë, shumë prej tyre nuk po arrijnë t'i kenë 15 vjet pune pas luftës.

Ju e dini se ne aktualisht kontribuojmë vetëm në trustin pensional, i cili nuk ka qenë me vetëdëshirë, por në njëfarë forme, na është imponuar dhe ka shumë vonesa në reformimin e sistemit pensional.

Së pari, në formë unike duhet të rregullohet çështja pensionale e pastaj në kategorizimin e çështjeve të veçanta. Fakti se nuk njihet stazhi pas luftës, ka krijuar edhe rritjen e presionit për njohjen e kategorive të veçanta, sepse është e qartë se ne nuk mund ta mohojmë kontributin, jo vetëm të punëtorëve të arsimit, punëtorëve të shëndetësisë, por edhe të punëtorëve të administratës, që janë solidarizuar me grevë dhe rrjedhimisht kanë mbetur pa punë dhe nuk e kanë pranuar regjimin e asaj kohe, ndërsa ka pasur punëtorë, atëherë që kanë vazhduar punën dhe sot ata i gëzojnë të gjitha te drejtat dhe këtu është e gjithë ajo pabarazi.

Ismajl Kurteshi, tha se dëshiroj t'i sqaroj disa gjëra. Se pari, në Komisionin për Arsim të gjitha subjektet politike janë të përfaqësuara dhe anëtarët e secilit subjekt politik kanë marrë pjesë, përveç anëtarit të Listës serbe. Të gjithë, edhe në leximin e parë, kemi votuar me konsensus për këtë ligj, pastaj edhe në Kuvend, në leximin e parë, e kemi kaluar në mënyrë konsensuale. Po ashtu, edhe në leximin e dytë, të gjithë anëtarët e komisionit e kanë votuar këtë ligj.

Kemi punuar vazhdimisht, në koordinim me Ministrinë e Financave, të cilët përherë na kanë tërhequr vërejtjen që mos të ngarkohet shumë buxheti, pastaj me ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me ministrin e Arsimit dhe Sindikatën e Arsimit dhe jemi munduar të gjejmë një mes, i cili i ka kompensuar punëtorët e arsimit dhe nuk e ka ngarkuar buxhetin.

Milaim Zeka, tha se më pëlqeu diskutimi i deputetes Kollçaku, sepse e tha shumë saktë dhe qartë se ne e kemi thye dinjitetin e krejt këtyre e njerëzve, duke mos ua njohur stazhin e punës, sepse akademiku është në nivel të pensionit, me atë që fare nuk ka shkollë dhe dëmi më i madh që i është bërë Kosovës është se pas luftës kanë udhëhequr të paditurit dhe kur udhëheq i padituri bën ligje të tilla, ku nuk ia njeh të drejtën e stazhit, pastaj çdo parti politike nuk ka diskutuar për ligje, por qysh të marrin vota.

Sa i përket kategorive që u diskutuan, e dinë më mirë ata që kanë qenë të burgosur në vitin 1981, kur është burgosur dikush në atë kohë, familjarët tjerë i kanë larguar prej

pune dhe janë diferencuar. Pra, kemi kategori që nuk janë diskutuar asnjëherë dhe kemi shumë grupe të prekura. Mendoj që dinjiteti i çdo njeriu kthehet me njohjen e stazhit të punës, para dhe pas lufte.

E mbështes edhe propozimin e deputetit Visar, që ne duhet t'ua ulim koeficientin së pari vetes dhe zyrtarëve të lartë, e pastaj ato para t'u shkojnë arsimtarëve.

Opinionin duhet ta dijë se këshilltarët e Presidentit, Kryeparlamentarit dhe Kryeministrit e marrin rrogën më të lartë se deputeti, kurse deputeti nuk ka as veturë dhe nuk ka as zyrë, duhet ditur se veç ata 80 zëvendësministra të Qeverisë të hiqen, ne i shpërblejmë këto kategori dhe ne në Kuvend duhet ta ngremë zërin dhe t'i rregullojmë këto probleme.

Kryesuesi, në fund, tha se si anëtar i komisionit, dua të shpreh mendimin tim rreth dy çështjeve. Pra, ashtu si e potencave, është një projektligj që shpeshherë ka kaluar në debatet, si nevojë e respektimit të punës dhe aktivitetit të kategorive, te cilat e kanë mbajtur arsimin shqip në vitet 90-ta.

Sa për informimin tuaj dhe opinionit publik, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar amendament me propozimin e 4 deputetëve, ku njëri ndër ta kam qenë iniciues, është bërë pjesë e ligjit dhe nuk është zbatuar dhe nuk ka gjetur zbatim asnjëherë, njohja e stazhit të personelit arsimor dhe shëndetësor që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës dhe kjo punë e ka historinë prej 6-7 vitesh.

Si domosdoshmëri e respektimit të saj, mendoj se ne duhet t'i japim mbështetjen në parim. Po ashtu, ka elemente brenda që sigurisht që Komisioni funksional i ka shqyrtuar dhe komisionet tjera, sepse në aspektin legjislativ janë 3 institucione që duhet të jenë në zbatim të këtij ligji, Ministria e Arsimit, Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Besoj që sponsoruesi i ka parë këto problematika deri në implementimin e plotë të saj, edhe pse në parashtrimin e këtyre amendamenteve, unë e pash që në të ardhmen do të kenë disa pengesa procedurale dhe ligjore, sidomos të nxjerrja e akteve nënligjore. Pra, nëse Komisioni funksional nuk do ta ketë aty vëmendjen e shtuar, dikush mund t'i ikë kësaj përgjegjësie, se kush është kompetent që sa më shpejt t'i nxjerrë këto akte ligjore, të parapara me ligj në afatin kohor prej 6 muajve.

Sido që të jetë për punën e pagesave, Kuvendi i Kosovës ka nevojë të hapë një debat të tillë, sepse buxheti mund të ketë një klasifikim dhe normativë më të mirë ligjore, sa i përket skemës pensionale. Ajo çka është e evidente, Republika e Kosovës ka arritur të paguajë shumë kategori që kanë kontribuar në të kaluarën. Komisioni funksional ka kryer një punë të mirë në harmonizimin e qëndrimeve mes grupeve parlamentare dhe mes atyre të cilët janë financues dhe i ndihmojnë buxhetit të Kosovës, që mos të kenë as në të ardhmen konsekuenca në raportet financiare, që ka me Bankën Botërore, Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Komisionin Evropian.

Pas diskutimeve, ftoi anëtarët të deklarohen me votë për këtë projektligj.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

8. Të ndryshme

Kryesuesi njoftoi se ka ardhur për vizitë delegacioni nga Kuvendi i Kroacisë, dje ishte takimi i parë, kurse sot do të takohemi në një drekë pune.

Milaim Zeka, propozoi dhe ftoi të gjithë anëtarët të japin mendimin e vet.

Jo rastësisht, por qëllimisht, tha se kam pasur takime me disa ambasadorë tanë që kanë shërbyer në vende të ndryshme, si p.sh. me Rexhep Bojën, Avni Spahiun dhe të tjerë dhe do të ishte mirë që ne si Komision për Integritet Evropian, t'i ftojme këta njerëz dhe të na njoftojnë se ku janë defektet e diplomacisë jashtë. Kam marr informacione shumë shqetësuese për mënyrën si funksionon diplomacia jonë.

Mendoj se si Komision për integritet Evropian, në bazë të informacioneve që na japin, mund të na shërbejnë kur të takohemi me ndërkombëtarët.

Kryesuesi theksoi se këtë mund ta bëjmë në koordinim me Komisionin për Punë të Jashtme për marrjen e informacioneve shtesë është domosdoshmëri edhe nga perspektiva jonë, në pjesën e integruese dhe për liberalizimin e vizave.

Ismet Beqiri, u pajtua me propozimin e parafolësit, për t'i ftuar ish- ambasadorët në një takim, por tha se mund të flasim lirshëm, vetëm ata që nuk kanë shpresë se mund të bëhen prapë ambasadorë, janë procedurat, por vetëm duhet mos të biem ndesh me kompetencat e komisionit.

Në vazhdim, tha se edhe pse nuk është temë diskutimi për sot, por e ndiej si obligim të them se ka qenë një fushatë nga disa individë dhe është diskutuar shumë çështja e pagave të deputetëve, jo për t'u arsyetuar, por një numër i madh i deputetëve jetojnë nga pagat, u përmenden një numër i madh i njerëzve, lloj këshilltaresh, pa dashur të fyej askënd, të cilët janë sjellë nga rruga dhe paguhen me shuma marramendëse. Pra, ata nuk bëhen temë dhe nuk diskutohen, ndërsa bëhen temë deputetët të mirë dhe të këqij, me meritën dhe pa meritën e qytetarëve, këta që janë dhe është shumë e qartë se në Kuvend nuk mundet askush të vijë pa votë. Kjo nuk është për të mbrojtur pagën tonë asses, por për të mbrojtur dinjitetin tonë, sepse kemi njerëz nëpër borde të kompanive që marrin shuma absurde dhe asnjë meritë nuk e kanë, por shkojnë me lidhje familjare.

Temë bëhen deputetët, objekt linçimi dhe fyerje dhe këtë nuk do ta lejojmë, kurse këta të fshihen me këto që bëjnë. Qeveritë shkojnë e vijnë dhe për mua është e papranueshme, cilado qeveri e cilido institucion, që ka gjithë këtë numër këshilltaresh dhe nuk e di çka i këshillojnë, përveç që marrin paga marramendëse, vërtet është e dhimbshme.

Fatmire Kollçaku, tha se po ashtu flitet edhe për udhëtimet e pafundme të zyrtarëve të ndryshëm qeveritarë, ndërsa ky komision ka arritur të realizojë vetëm një vizitë, ndërsa quhet Komision për Integritet Evropian, ka qenë plotësisht i pamundësuar në realizimin e çështjes së lobimit.

Kjo tregon sa është i anashkaluar ky komision, përderisa edhe në bashkëpunim me ambasadat tona nuk kemi arritur ta ndërmarrim asnjë aktivitet lobues.

Ne kur i ftojme ministrat në komision, gati çdoherë janë nëpër udhëtime jashtë vendit, por rezultatet nuk janë askund dhe kemi degradim të procesit dhe asgjë nuk po ec përpara.

Ismajl Kurteshi, tha se për çështjet që u diskutuan, lidhur me privilegjet e përhershme, rrogat e mëdha marramendëse dhe çështja e udhëtimeve të delegacioneve të mëdha janë tema shumë të qëlluara, por ka nevojë të iniciohet një debat parlamentar në Kuvend, të diskutohen këto çështje dhe pastaj të dalë me rekomandime Kuvendi, sepse në komision veç mund të bisedojmë dhe këtu përfundon.

Milaim Zeka, tha se në deputetët jemi bërë tabelë qitëse e mediave, për arsye se grupet mafioze u japin para mediave. Ato janë ndërmarrjet publike dhe ministritë tona, të cilat japin para t'ua mbyllin gojën për të mos folur sa shpenzojnë dhe sa marrin. Ne, si deputetë, duhet mbrojtur dinjitetin tonë. Mediat tona dhe gazetarët mendojnë që në për çdo mbledhje dhe seancë plenare marrim mëditje, por nuk e dinë se 20 mbledhje dhe 20 seanca po të mbahen, në marrim veç për dy seanca dhe dy mbledhje, kështu që ka shumë dezinformata rreth deputetëve, kurse 80 zëvendësministra, shtetit të Kosovës dhe qytetarëve të Kosovës iu kushtojnë sa 600 deputetë, prandaj do të hapim debat në Kuvend shumë shpejt, për këto, dhe opinioni do të informohet drejt.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

Përgatitur nga:
Njësia për mbështetjen e komisionit.

Nënkryetar i parë i komisionit,
Armend Zemaj
